



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 41

Datë: 20. 10. 2020. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burmi Ahmetaj, kryeshef i KQZ-së.

Përkthyesë: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.38 dhe 39/2020;

2. Aktivitetet e SKQZ-së:

3. Njoftim lidhur me raportin e vlerësimit të materialeve zgjedhore dhe implikimet buxhetore pas shtyrjes së zgjedhjeve në Podujevë.

4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

- Shqyrtimi dhe miratimi i interpretimit ligjor, lidhur me rekomandimin e Zyrës për Regjistrim e Partive Politike dhe Certifikim për publikimin e raporteve vjetore financiare të Partive Politike për vitin 2019.
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike Yenilikçi Türk Hareket Partisi' (YTHP) .
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndërrim të logos të partisë politike Partia Socialdemokrate (PSD).

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Udhëzimit Administrativ nr. 01/2020 për Publikimin dhe Përditësimin e Informatave në Ueb Faqen e KQZ-së dhe Procedurës për Publikimin dhe Përditësimin e informatave në Ueb Faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Të ndryshme.

1.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Vadete Daka: Kush është për këtë rend dite, kuptohet me ndryshimet që u propozuan paraprakisht ?

Në fillim, nga anëtarët e KQZ-së, u shqyrtuan dhe u miratuan procesverbalet nga mbledhjet nr.38, dhe 39/2020 të KQZ-së.

(P.s. Jashtë rendit të ditës, u diskutuar rreth cështjes së postit të kryeshefit që në këtë rast, bëhet fjalë për z. Burim Ahmetaj. Në këtë pikë, diskutuan: Alim Rama, s'i initiator i këtij diskutimi, Arianit Elshani që kërkoi t'ë diskutohet vetëm në bazë të agjendës së miratuar të mbledhjes, ndërsa Sami Kurteshi dhe Alim Rama, insistuan që pavarësisht, të diskutohet edhe njëherë cështja e kryeshefit. Kryetarja, Valdete Daka inistoi që mbledhja të vazhdojë sipas agjendës së votuar nga anëtarët e KQZ).

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Njoftim lidhur me reportin e vlerësimit të materialeve zgjedhore dhe implikimet buxhetore pas shtyrjes së zgjedhjeve në Podujevë:

Burim Ahmetaj: Sekretariati, ju ka dërguar një imell me aktivitetet e zhvilluara deri më 16 trtor, 2020. Në disa pika, z. Ahmetaj dha shpjegime mjaftueshëm të detajuara rreth këtyre aktiviteteve që ndërlidhen mes vete, kundrejt aktiviteteve të rregullta të Sekretariatit: Plani strategjik 2021 – 24 (draftplani), buxheti i vitit 2021 i KQZ-së (mbi bazën e shkurtimeve qeveritare, do të jetë më i vogël për 3 366 451 euro), dhe vizitat që planifikohen në zyrat komunale të KKZ-së.

Alim Rama: Në mbledhjen e 38 kemi kërkuar raport lidhur me përdorimin e veturave. Ende nuk kemi përgjigje...!

Burim Ahmetaj: Sekretariati, e ka përgatitur reportin për shfrytëzimin dhe shpenzimet e veturave zyrtare dhe ne jemi duke e pritur reportin e financave, dhe sapo të jetë gati ne do t'ju informojmë...

Alim Rama: Ne, kërkojmë rapport për shembull nga partitë politike, e nuk kemi transparencë këtu, te ne... Kjo ka qenë edhe vërejtje e auditorit...!

Arianit Elshani: Ndryshimet që kanë ndodhur në Sekretariat, kanë ndikaur edhe në punën e sekretariatit...

Valdete Daka: Nëse janë kryer raportet, kryni procedurat dhe na i dërgoni...

Ibrahim Selmanaj: U informuam që ka shkurttime buxhetore mbi 3 milion euro! Cilët do të jenë hapat e Sekretariatit në këtë drejtim...?

Burim Ahmetaj: Kemi pasur dëgjimin buxhetor për shkurtesa, dhe kemi dokumentuar të gjitha vendvotimet që janë shtuar në KQZ. Pjesa më e madhe e buxhetit, rreth 70% shkon në Këshillat e Vendovimeve dhe stafin mbështetës... Në secilin proces zgjedhor, bëhet rritja e vendvotimeve dhe e qendrave të votimit, dhe ne nuk kemi s'i t'i reduktojmë shpenzimet, planin buxhetor...

Shumë fakte, i kemi argumentuar qendrimet tona. Kemi bërë shkurttime buxhetore për shkak të pandemisë, po ne duhet patjetër të qëndrojmë mbrapa qendrimeve tona...

Valdete Daka: Ju njoftoj se janë dekretuar zgjedhjet në Podujevë dhe Mitrovicë të veriut, edhe zyrtarisht...

Njoftim lidhur me reportin e vlerësimit të materialeve zgjedhore dhe implikimet buxhetore pas shtyrjes së zgjedhjeve në Podujevë.

Burim Ahmetaj: Sekretariati, ka përgatitur një raport lidhur me zgjedhjet në këto dy komuna, të gjitha materialet janë në QNR, dhe ne i kemi verifikuar dhe ato material që nuk kanë ndryshime to të përdoren, dhe ndonjë aktivitetet ose material që duhet të realizohet s' shtesë për shkak të ndërprerjes së procesit. Për komunën e Podujevës, buxhet shtesë nuk ka nevojë të ketë, por janë disa cështje procedural që duhet t'i shohim, specifikojmë...

Në përgjithësi, z. Ahmetaj, e pasqyroj rapportin e Sekretariatit mbi vlerësimin të detajuara në kontekst të përgatitjes së vazhdimit të mbajtjes së zgjedhjeve komunale në komunën e Podujevës...

Alim Rama: Janë disa cështje që në raport, ndoshta nuk kanë mundur të parashikohen, s'i informimi i votuesve, vëzhguesit e zgjedhjeve...Nuk presim që vëzhguesit mund të jenë të nejtë, tash jemi 8 muaj mbas zgjedhjeve dhe mund të ketë votues të rinjë që I kan mbushur 18 vjetë...

Burim Ahmetaj: Nuk kemi pararë as informim, as krijimin e listave të reja votuese mirpo, kemi paraparë që të vazhdojmë aty ku ka mbetur procesi...

Arianit Elshani: Kam pritur që përfaqësuesit e VV-së e përshëndesin shpalljen e zgjedhjeve nga presidenti në Podujevë dhe 147 në Mitrovicën e veriut, ndërsa sa I përketë rapportit të kryeshefit, mendoj që edhe ato cështje që i përmendi Alimi i takojnë Sekretariatit që të bëhet një plan operacional për të gjitha cështjet me rëndësi, përfshirë edhe për komunën e Mitrovicës së veriut...

Sami Kurteshi: Mendoj që duhet të bëhet një raport I mirë! Lista votuese, duhet të pastrohet... Ne s'i VV, së paku kemi kërkuar që të arsyetohet nga ISHKK-së për apo kundër mbajtjes së zgjedhjes. Ata, nuk e kan bërë këtë, por tanë dekreti është shpallur, por pa konsultim me partitë

politike, gjithnjë sipas ligjit... Kjo shpallje e presidentit, është bërë në mënyrë jo transparente, e kundërligjshme...

Arianit Elshani: Lidhur me gjëra që I përmendi z. Kurteshi, por sidomos më duhet të diskutoj lidhur me presionin që I bëhet sekretariatit. Ne, jemi zyrtar publik, dhe duhet të sillemi në bazë të rregullores dhe ligjeve. Kërkoi nga ju kryetare që, të përdorni autoritetin tuaj por edhe duke I respektuar rregullat bazike ligjore...

Valdete Daka: Sa u përketë shkresave, askush nuk mund të dërgoj shkresa në emrin personal, por vetëm nga unë – kur e aprovon KQZ. Pra, dihet hiaerarkia, rendi dhe protokoli I punës...

Distanca me zyrtarët e Sekretariatit duhet të ruhet, duhet të jetë zyrtare dhe mbi raportet e punës...

Sami Kurteshi: Këto janë akuza kriminale për mendimin tim! Unë, dua të shpjegoj këtu se, a kam shkruar unë...

2.

VAZHDIM I MBLEDHJES 41

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: Ashtu sic u morën vesh, unë e hapi mbledhjen e 42-të. E keni rendin e ditës që fillon nga këshillat e KQZ-së. Propozoj që këshilli për financa të filloj i pari, meqë e kemi me urgjencë.

Kush është për këtë rend dite ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës me 9 vota për.

2. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës në Podjevë dhe në Mitrovicën e veriut.

Sami Hamiti: Në këshill, kemi shqyrtruar planit të buxhetit shtesë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës në Podjevë dhe, dhe buxhetin për zgjedhjet në Mitrovicën e veriut. Buxheti shtesë për zgjedhjet në Podujevë, e kemi vu mbasi që e kemi analizuar mirë. Ka një referim buxheti shtesë te UV llambat që u ka skaduar afati gjë që, nuk guxojmë të kemi probleme, është edhe informimi publik, pjesa

e transportit dhe lista votuese. Nuk është shpenzim i madh, por faktorë të tjerë kanë ndikuar që, kjo shtesë të futet në proces.

Shpenzimet në Mitrovicë, janë më të vogla krahasimisht me zgjedhjet e tjera të jashtëzakonshme për një komunë, sepse janë në pyetje dy komuna dhe stafi jo permanent angazhohet për të dy komunat. Janë edhe shpenzimet për orët shtesë sipas ligjit të punës...

Valdete Daka: Kush është për këtë plan të buxhetit për këto zgjedhje ?
Anëtarët e KQZ-së, unanimisht e votuan këtë rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për orët shtesë jashtë orarit të rregullit të punës

Sami Hamiti: E kemi shqyrtuar edhe këtë pikë. Na duhet një mriatim formal i një vendimi për orët shtesë sipas ligjit. Është deri në 40 orë. Pra, jemi brenda ligjit por, na duhet një miratim formal.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht këtë rekomandim.

3. Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimit të stafit jo permanent në komunën e Podujevës dhe të Mitrovicës së veriut

Ibrahim Selmanaj: Në mungesë të kryesuesit, do të ju njoftoj unë. Këshilli, ka diskutuar për zhvillimet në dy komunat ku i kemi zgjedhjet. Pra, kemi pasur një numër të stafit të angazhuar në Podujevë. Ekziston mundësia të vazhdojmë me stafin që e kemi pasur të rekrutuar, dhe të rekrutojmë stafin e ri në Mitrovicën e veriut...

Pra, të fillohet puna menjëherë... Dhe tjetri staf, sipas specifikave që ne i kemi përcaktuar të rekrutohet...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht këtë rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit lifhur me orarin e punës përgjatë procesit zgjedhor

Ibrahim Selmanaj: Në mbledhje, kemi diskutuar edhe për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe për punëtorët e Sekretariatit. Është një propozim, ashtu si edhe vendimi, pra vendimin e keni përpara...

Në këtë pikë, diskutuan: Valdete Daka, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht këtë rekomandim.

4. Këshilli për Operacione Zgjidhore

Shqyrtimi dhe miratimi i afateve të shkurtuara të procesit zgjedhor në Mitrovicën e veriut

Alim Rama: Në këshill ne kemi diskutuar dhe analizuar planin operacional të këtyre zgjedhjeve, dhe vendimin për shkurtimin e afateve. Ne, jemi në zgjedhje të jashtëzakonshme dhe, para jush janë afatet, disa të shkurtuara. Pra, Sekretariati ka mundësi që t'i operacionalizoj sipas këtij plani afatet që ne i kemi rekanduar. Sa i përketë fushatës, nuk kemi marrë vendim, pra nuk është e cekur në plan, por edhe për fushatë mendoj që të përdoren shkurtim... Disa operacione, janë të njëjtë për të dy komunat, e disa nuk janë sepse, dihet...

Valdete Daka: Sa po e shoh, fushata fillon me 12 nëntor dhe përfundon me 25 nëntor. Pra, e keni lënë 15 ditë...? A është ky vendim për Mitrovicën e veriut...?

Alim Rama: Po...

Sami Hamiti: Në Podujevë, fushata është e kryer! Madje, nëse i nënshtrohemi udhëzimeve ISHK-së, do të jetë problem mbajtja e fushatës, madje edhe në Mitrovicën e veriut...

Arianit Elshani: Është diskutuar por, nuk është shqyrtuar për Poduevë. Mendoj që për Mitrovicën ne duhet ta votojmë afatin e fushatës, por për Podujevë është mirë që edhe njëherë të diskutorhet ne KOZ, dhe ne të shohim e, pastaj të vendosim në një mbledhje tjetër lidhur me këtë... Pajtohem me mendimin tuaj që është një cështje e ndarë...

Alim Rama, insistoi që të ketë përsëri fushatë...

Valdete Daka: Mendoj që, njëherë të votojmë për afatet e shkurtuara për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Mitrovicë të veriut, kurse për Podujevë flasim në takimin e nesërm...

Kush është për këtë rekomandim... ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.

Valdete Daka: Po mbetet që nesër të takohen edhe këshilli për cështje ligjore, edhe këshilli për operacione zgjedhore lidhur me cështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e ndryshme, ndoshta nuk e di nëse mund të përsëriten në Podujevë...

Alim Rama: Edhe në diasporë ka me pas votues që i kan mbush 18 vjet...!

Shqyrtimi dhe miratimi i planit operacional

Alim Rama: Plani, ka të bëjë me të gjitha veprimet e zgjedhjeve edhe në Podujevë, edhe në Mitrovicën e veriut. Kështu, këshilli rekomandon me e votue këtë plan, madje edhe për ato aktivitetet që duhet me u përsëritë...!

Valdete Daka: Ligjërisht, a mundemi me i futë të dy komunat në të nejetin plan operacional ? Kjo, është vendimmarje ligjore. Unë, i kisha ndarë vec e vec...! Shikoni edhe njëherë, sepse ka aktivitete që nëse përsëriten mund të shkaktojnë ndikime ligjore...

Nëse pajtoheni, unë do të votoja vetëm për Mitrovicën e veriut...

Arianit Elshani: Pajtohe me këtë, është një rekomandim i mirë për faktin se mund të duplikohen këto veprime. Prandaj, duhet t'i koordinojmë veprimet, por edhe të ndahen veprimet. Mirë, të votojmë njëherë planin vetëm për Mitrovicën e veriut, dhe për Podujeven ta shqyrtojmë edhe njëherë në KOZ, dhe se cka duhet ndërmarrë...

Alim Rama: KOZ-i nuk është organ vendimarrës, kështu që në KOZ duhet të trajtohen të gjitha aktivitetet që duhet me u përsërítë... As Sekretariati nuk e ka këtë fuqi vendimarrëse. Ne, në parim jemi pajtuar në KOZ...

Listat votuese, duhet të përdoren të reja. Fushata e informimit publik, duhet të bëhet e njejtë... Edhe në buxhet, jemi pajtuar që mjetet të përdoren nga një komunë në tjetrën...

Valdete Daka: Unë, vetëm kërkova që të bëhet filtrimi i aktiviteteve... Një tjetër cështje, kisha kërkuar nga Sekretariati që të na garantoj se, a mundet me i organizue zgjedhjet në veri pa ndihmën e OSBE-së...

Burim Ahmetaj: Do ta vlerësojmë situatën, dhe nesër do të japim përgjigje. Ndërsa, për planin operacional, gjithëcka që ndërlidhet me këtë proces...ndoshta, për komunën e Podujevës do ta hartojmë një plan të ri... Ka aktivitete të ndryshme që nuk janë të njëjta...

Valdete Daka: Kush është për aprovimin e planit operacional në Mitrovicën e veriut...?

Anëtarët e KOZ-së, miratuan unanimisht këtë plan.

3.

VAZHDIM I MBLEDHJES 41

Valdete Daka: Ne e kemi një rend dite, por ne ende se kemi përfunduar mbledhjen nr. 41. Do të vazhdojmë...me raportin e këshillave...Ju lutem të jemi sa më të shkurtër, sepse e kemi urgjent buxhetin dhe sot, duhet ta dërgojmë sipas afatit ligjor deri ën oren 4:00...

3.Raporti i Këshillave të KOZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i interpretimit ligjor, lidhur me rekomandimin e Zyrës për Regjistrim e Partive Politike dhe Certifikim për publikimin e raporteve vjetore financiare të Partive Politike për vitin 2019

Arianit Elshani: Këshilli ka shqyrtuar interpretimin ligjor lidhur me rekomandimin e ZRPPC-së për publikimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin 2019. Ne, kemi marrë një rekomandim nga kjo zyre, mirëpo kemi marrë edhe një interpretim ligjorë nëse nevet, na lejohet ose jo publikimi i tyre... Për shkak të dallimeve që kemi pasur në këshill, nuk kemi marrë ndonjë qëndrim por kemi lënë që, kjo të shqyrtohet në KQZ.

Drejtori i zyres, Ylli Buleshkaj, para anëtarëve të KQZ-së, shpjegoi elementet e rekomandimit të zyres.

Valdete Daka: Rekomandimi i zyrës për raportet finanaciare të subjekteve politike, të pa audituara të publikohen. A ka dikush të shtoj rreth kësaj...?

Sami Kurteshi: Unë, kam dhënë pikëpamjet e mia dhe mendoj se raportet duhet të publikohen dhe kjo është kërkesë, edhe e shumë organizatave dhe institucioneve... Dhe se, rekomandimi është që të publikohen në ueb faqen e KQZ-së me informaten se, raportet nuk janë të audituara... Bile, mendoj se raportet, duhet kërkuar edhe partitë që raporet e tyre t'li publikojnë në ueb faqet e tyre... Po ashtu, pajtohem që ne mbledhjet t'li mbajmë sipas rregullores së punes, dhe Sekretariati të na e përgadisë që ta kemi rregoloren që nga mbledhja e ardhshme...

Alim Rama: Ligji në nenin 15 fletë për raportin finanziar që duhet të publikohet, por edhe s'i të publikohen ato nga partitë politike...

Sami Hamiti: E kemi debatuar edhe më herët, madje duke kërkuar një interpretim ligjor. Po, në ligj rapporti finanziar dhe pasqyrat financiare duhet të publikohen... Por, plotësimi dhe ndryshimi I ligjit që është në procedur parlamentare të publikohen, edhe pa u audituar... Unë, e përkrahi këtë që të publikohen, pra ato janë dorëzuar dhe se nuk janë sekret...

Ibrahim Selmanaj: Po, të gjithë jemi për dhe, të publikohen...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim me 9 vota për!

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike Yenilikçi Türk Hareket Partisi' (YTHP)

Ylli Buleshkaj: Ashtu sic e keni rekomandim, bëhet fjalë për partinë e re novatore turke. Ne, në zyre e kemi shqyrtuar cdo gjë mbi bazë të ligjit, ka qenë në shqyrtim public dhe nuk ka pasur asnjë ankesë... Dhe ne, rekomandojmë për regjistrimin e kësaj partie të re...

Rifat Krasniq: Unë, kam një s'i kërkesë, por edhe s'i vërejtje. E para, personi që e ka formuar partinë është I kundërligjshëm. Pse, ai është gjykuar nga gjykata në Prizren. Është ende në procedurë se, ka qenë drejtor në komunë. E dyta, kam shumë vërejtje prej komunitetit turk se, nënshkrimet janë marrë pa u konsultuar me qytetarët - nënshkruesit... Po pyes zyren: personi themelues është ende në gjykatë, kurse nënshkrimet janë flaso...

Yll Buleshkaj: Legjislacioni e parasheh shumë mirë se kush mundet dhe kush nuk mundet të krijojë parti politike. Nëse e kishim ka ndonjë padi që s'ka vendim të prerë gjyqësorë dënim, kjo nuk e pengon dikend që të formojë parti politike, dhe ne nuk e pengojmë... Ne, nuk i kemi shkuar askujt në shtëpi për ta verifikuar, por ne l kemi verifikuar të dhënat dhe ato janë të sakta, nuk ka nënshkrime të nënshkruara vetëm prej një personi, nëse ka dikush dyshime mund të bëjë kërkesë dhe prokuroria e ka teknikën e verifikimit... Secili që ka dyshuar, ka mundur të vi gjatë javës për të parë nëse pa lejen e tij është në listën e nënshkrimeve... Nuk kemi mjete të sofistikuara, dhe as tjetër metodë...

Valdete Daka: Pra, na u dha arsyetimi I zyrës. Unë, e hedh në votim. Prandaj, kush është për që, subjekti që ka aplikuar për regjistrim “Yenilikçi Türk Hareket Partisi” (YTHP) në krye me Ertan Simitci, të regjistrohet si partia e 45-të në Regjistrin e ZRPP ?

Me 8 vota për, dhe me 2 vota abstenim ky subjekt nuk regjistrohet. Por, sipas ligjit në momentin që kjo parti nuk regjistrohet në KQZ ka të drejtë ankesë në PZAP.

Alim Rama: Për mua, ky refuzim është absurd...

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndërrim të logos të partisë politike Partia Socialdemokrate (PSD)

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar rekomandimin për refuzim të ndërrit të logos të partisë politike Partia Socialdemokrate. S'i këshill, është kërkua nga ZRPP që të vazhdoj komunikimin me subjektin se cila është kërkesa reale për ndryshim, sepse komunikimi është ngatërruar, ndoshta si rezultat I pandemisë...Ne, kemi kërkuar që të ketë komunikim edhe me këtë subject, por edhe me të gjitha institucionet e tjera, në kontekst, sepse strëzgjatjet nuk janë gjithmonë të arsyeshme...

Valdete Daka: Zyra, duke e parë se nuk janë përbushur kërkesat ligjore të PSD-së për ndryshim të logos, është rekomanduar që KQZ ta refuzoj këtë kërkesë...Kush është për refuzim...?

Me 9 vota për, anëtarët e KQZ –së miratuan rekomandimin për refuzimin e ndërrimit të logos të partisë politike Partia Socialdemokrate (PSD)

Shqyrtimi dhe aprovimi i Udhëzimit Administrativ nr. 01/2020 për Publikimin dhe Përditësimin e Informatave në Ueb Faqen e KQZ-së dhe Procedurës për Publikimin dhe Përditësimin e informatave në Ueb Faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar këtë udhëzim, dhe rekomandojmë që kjo të shqyrtohet edhe njëherë, dhe pastaj të vie përsëri në mbledhje të KQZ...Pra, kjo është vetëm si njoftim – infomim...

4. Të ndryshme.

